**VENDIM**
**Nr.849, datë 11.6.2008**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA DHE MINISTRIVE E INSTITUCIONEVE BUXHETORE, PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË NGA RRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 27.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrive dhe institucioneve buxhetore, në buxhetet e miratuara për vitin 2008, t'u shtohet fondi 110 458 500 (njëqind e dhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për kryerjen e pagesës shtresave në nevojë, për mbrojtjen nga rritja e çmimit të energjisë elektrike.
2. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, programi "Mbrojtja sociale" (Gr.25, Tit.10430, Kap.1, Art.606), t'i pakësohet fondi prej 110 458 500 (njëqind e dhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekësh.
3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

LISTA E INSTITUCIONEVE PËR ENERGJINË ELEKTRIKE 2008

në lekë

| **Kod.Min** | **Emërtimi i institucionit** | **Fondet Viti 2008** |
|---|---|---|
| 1 | Presidenca | 48 000 |
| 2 | Kuvendi | 24 000 |
| 4 | Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | 150 000 |
| 5 | Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit | 1 446 000 |
| 6 | Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunukacionit | 1 086 000 |
| 11 | Ministria e Arsimit dhe Shkencës | 70 000 000 |
| 12 | Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | 444 000 |
| 13 | Ministria e Shëndetësisë | 19 635 500 |
| 16 | Ministria e Brendshme | 1 308 000 |
| 17 | Ministria e Mbrojtjes | 9 497 000 |

| | | |
|---|---|---|
| 18 | Shërbimi Informativ Shtetëror | 787 000 |
| 26 | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave | 4 680 000 |
| 28 | Prokuroria e Përgjithshme | 540 000 |
| 29 | Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor | 609 000 |
| 30 | Gjykata Kushtetuese | 66 000 |
| 31 | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 72 000 |
| 55 | Shkolla e Magjistraturës | 6 000 |
| 67 | Komisioni i Shërbimit Civil | 6 000 |
| 76 | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive | 30 000 |
| 77 | Autoriteti i Konkurrencës | 6 000 |
| 78 | Ministria e Integrimit | 18 000 |
| | **Totali** | **110 458 500** |